

VENDIM
Nr. 776, datë 15.12.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË KRIJIMIT TË SISTEMIT TË GJURIMIT TË ARTIKUJVE PIROTEKNIKË¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Etiketimin e artikujve piroteknikë me një numër regjistrimi, që përmban të dhënat e mëposhtme:

a) numrin katërshifror të identifikimit të Organizmit Evropian të Notifikuar që ka lëshuar certifikatën e përputhshmërisë, në përputhje me nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, sipas procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë, referuar:

- i. kontrollit të tipit EU (moduli B);
- ii. përputhshmërisë së bazuar të verifikimit të njësisë së produktit (moduli G);
- iii. përputhshmërisë së bazuar të sigurisë së plotë e cilësisë (moduli H);

b) me shkronja kapitale, në format të shkurtuar, kategorinë e artikullit piroteknik për të cilin përputhshmëria është certifikuar, si më poshtë:

- i. F1, F2, F3 ose F4, për fishekzjarrët e kategorive 1, 2, 3 dhe 4;
- ii. T1 ose T2, për artikujt piroteknikë teatralë të kategorive T1 dhe T2;
- iii. P1 ose P2, për artikujt e tjerë piroteknikë të kategorive P1 dhe P2;

c) numrin e ekzaminimit të përdorur nga Organizmi Evropian i Notifikuar për artikullin piroteknik.

2. Numri i regjistrimit strukturohet “XXXX — YY — ZZZZ ...”, ku XXXX i referohet shkronjës “a”, të pikës 1; YY i referohet shkronjës “b”, të pikës 1, dhe ZZZZ... i referohet shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi.

3. Prodhuesit dhe importuesit e artikujve piroteknikë kanë detyrimin që:

a) të mbajnë një regjistër fizik dhe elektronik të të gjithë numrave të regjistrimit të artikujve piroteknikë të prodhuar ose të importuar prej tyre, së bashku me emrin e tyre tregtar, llojin e përgjithshëm dhe/apo nëntipin, dhe vendin e prodhimit për 10 vjet, pas vendosjes në treg të artikullit, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) të transferojnë të dhënat tek autoritetet kompetente licencuese për veprimtarinë e tyre, në rast se prodhuesi ose importuesi pushon veprimtarinë e tij;

c) të regjistrojnë vendndodhjen e çdo artikulli piroteknik, ndërkohë që artikulli piroteknik është në zotërimin ose kujdestarinë e tyre, derisa ai të transferohet drejt një operatori tjetër ekonomik ose të përdoret;

ç) të testojnë, në intervale të rregullta, sistemin për mbledhjen e të dhënave, me qëllim që të sigurohen që ai të mbetet i vlefshëm dhe të sigurohen për cilësinë e të dhënave të regjistruara;

d) administratori i subjektit ose drejtuesi teknik të japin informacion në lidhje me sistemin në çdo kohë që kërkohet nga autoritetet kompetente edhe jashtë orarit normal të punës;

dh) të vendosin në dispozicion të autoriteteve kompetente dhe të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut të gjithë informacionin e përmendur në shkronjën “a”, të kësaj pike, sipas kërkesës së bërë nga këto autoritete.

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën 2014/58 BE, të Komisionit Evropian, datë 16 prill 2014, “Për ngritjen e një sistemi për gjurmimin e artikujve piroteknikë, në zbatim të direktivës 2007/23/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”; numri CELEX 32014L0058, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 115, datë 16.8.2014, f. 28–31.

4. Artikujt piroteknikë, të cilët janë vendosur në treg para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të lejohet të tregtohen.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Shtojca I

Formati i regjistrimit i referuar në pikën 3, shkronja “a”

Numri i regjistrimit	Data e lëshimit të certifikatës së shqyrtimit të tipit EC (moduli B), certifikata e konformitetit (moduli G) ose miratimi i sistemit të cilësisë së sigurisë së produktit (moduli H) dhe data e skadimit, sipas rastit	Prodhuesi	Tipi i produktit (i përgjithshëm) dhe nëntipi, nëse zbatohet	Moduli i konformitetit i fazës së prodhimit¹	Organi i notifikuar që kryen vlerësimin e konformitetit në fazën e prodhimit¹	Informacion shtesë

¹ Duhet të plotësohet gjithmonë nëse kryhet procedura e vlerësimit të përputhshmërisë sipas modulit B, të referuar në nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”. Nuk kërkohet për procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë, të referuara në nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, (modulet G dhe H). Informacioni duhet të jepet (kur dihet), nëse përfshihet një organizëm evropian tjetër i notifikuar.